



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:009708

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05696552

A.nr.137/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ të paditësit, ... të cilën e përfaqëson ... e ... në P..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson ... me autorizim kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) me seli në Prishtinë, me bazë juridike: anulim vendimi, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarës të palës paditëse, të autorizuarit të palës së interesuar, dhe në mungesë të palës së paditur me datë 18.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit, ..., me të cilën ka kërkuar anulohet vendimi i të paditurit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me nr. A.nr.3252/2020 me numër të protokollit 9625 i datës 21.12.2020, **si e pa bazuar**.

A r s y e t i m

Me datën 18, është mbajtur shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridiko-administrative, sipas dispozitave të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në prani të autorizuarës së palës paditëse dhe të autorizuarit të palës Interesit – dhe në mungesë të palës së paditur e cila është ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore ((Provë: flet-kthesa e datës 19.03.2024).

Paditësi me padinë e datës 20.01.2021 ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e tij dhe të anulojë vendimin e të paditurit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me nr. A.nr.3252/2020 me numër të protokollit 9625 i datës 21.12.2020.

Ndërsa e autorizuar e palës paditëse në seancën e shqyrtimit kryesore ka kërkuar nga gjykata që aprovohet kërkesëpadia si e bazuar dhe të anulohet vendimi i të paditurës, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit ... duke anuluar

vendimin e datës 25.12.2020 dhe se trajtimin e ankesës e ka bërë jashtë çdo norme ligjore duke mos konstatuar gjendjen faktike pa u lëshuar fare në provat e dorëzuara nga paditësja dhe se bazuar në provat e bashkangjitura në padi shihet qartë se vendimi i te paditurës është i njëanshëm i cili nuk ka marr për bazë asnjë provë nga ... madje nuk ka marr as parasysh afatin prej 5 ditësh për përgjigjen në ankesë dhe para se te merr këtë vendimin me nr.A.nr.397-23 datës 21.12.2020, duke vepruar ne kundërshtim me nenin 16 te Ligjit KPSHCK si dhe Rregulloren nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat për Ankesat. Në fund thekson se, vendimi i te paditurës është i pa bazuar dhe i jo ligjshëm, andaj duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të Konfliktit Administrativ i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të aprovohet padia dhe të anulohen vendimi kontestues i te paditurës.

I autorizuari i palës se interesit në seancën e shqyrtimit kryesore ka kërkuar nga gjykata që të refuzohet padia si e pa pabazuar pasi që njëjta nuk është e mbështetur e as me prova dhe as me dispozita Ligjit të Konfliktit Administrativ për arsye pse vendimi i te paditurës është në pajtim të plot me gjendjen faktike dhe dispozitat ligjore ashtu që ky vendim është vërtetuar edhe nga padia edhe nga pala e interesuar e cila ka përfunduar nga dy shkallët të gjykimit me nr.AR.166/2020 dhe AA.nr.837/2021 ku pala e interesuar ka fituar të drejtën gjyqësore për tu kthyer në vendin e tij punës dhe i njëjti vërteton ligjshmërinë e aktin kontestues të pretenduar nga paditësja, andaj mbi këtë bazë i propozon gjykatës që këtë padi ta hedhë si të pabazuar dhe ta lënë në fuqi vendimin të paditurës.

I padituri, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në përgjigjen në padi të datës 03.11.2022, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pa bazuar dhe ta vërtetojë vendimin e Këshillit me nr. A.nr.397/2020 i datës 21.12.2020 , si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 18.04.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimi i dt.21.12.2020 me nr.397/20; Kërksa e dt.17.12.2020 me nr.9383; Ankesa e dt.08.12.202; Përgjigjja ne ankese e dt.22.12.202; Kërkesa e dt.22.09.2020; Email i dt.18.09.202 dhe i dt.17.09.2020; Vendimi i dt.29.06.2020 me nr.14151; Email i dt.29.06.2020; Kontrate Kornize me nr.6284; kërkesa e dt.21.08.2020; Email i dt.11.09.2020; Email 31.08.2020; Plani i Implementimin i dt.31.12.2019; Vendimet i dt.04.09.2020; Shkresat e dt.23.10.2023. Kërkesa per hetime e dt.20.11.2020; Vendimi i dt.19.11.2020; Procesverbali i dt. 17.11.2020; Email i dt.10.11.2020 dhe i dt.06.10.2020; Raporti i dt.28.07.2020 me nr. protokolli 4256; Shkresa e dt.18.09.2019; Pagesat e dt.20.09.2019 dhe e dt.14.01.2020 dhe e dt.20.09.2019; Numri i fletngarkimit dt.14.02.2020; Kallezimi penal i dt.23.11.2020; Email i dt.11.11.2020 dhe 10.11.2020 dhe 06.11.2020; Vlersimi i dt.23.11.2020; Email i dt.26.11.2023; Shkresat e dt.01.12.2020; Vendimi i dt.25.11.2020; vendimi i dt.24.10.2020; Vendimi i dt.29.06.2020; Kërkesa nr.21.08.2020; vendimi i dt.19.11.2020 dhe auditimiti i dt.19.11.2023; Aktgjykimi i dt.08.07.2021 me nr.1662/2020; Aktgjykimi i dt.16.09.2022 me nr.AA.nr.837/2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurës dhe deklarinim në seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës së kësaj çështje administrative, konstatoi se padia paditësit është e pa bazuar.

Gjykata gjen se, me datën 25.11.2020 ka nxjerr vendim me numër 01Ref.nr.45 me të cilin ankuesi pezullohet nga puna me 50% te pagës me arsyetimin se për mos përmbushje te detyrave te punës, mosrespektim të afateve të përcaktuar në përmbushjen e detyrave të cilat kanë sjell pasoja të rënda, moszbatim të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale, dëmtim i pasurisë shtetërore, përdorim i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimit i pasurisë shtetërore, shkelje e detyrimeve te përcaktuara ne ligj, kryerja e veprimeve që cenojnë nëpunësit civil , institucioni apo shërbimi civil në tersi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.

Me tej, ankuesi ..., kundër këtij vendimi ka ushtruar ankesë pran të paditurës Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me datën 08.12. 2020, ndërsa kjo e fundit me vendimin me numër A.nr.397/2020 të datës 21.12.2020, ka aprovuar si e bazuar ankesën me numër A.nr.397/2020 e datës 08.12.2020 e parashtruar nga ankuesi ..., është shfuqizuar Vendimi me numër 01Ref.nr.45 i datës 25.11.2020 i Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ashtu që është, që të bëjë zbatimin e vendimit brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës në pozitën sipas marrëdhënies se punës dhe të bëjë kompensimin e 50 % të pagës nga dita e pezullimit deri në momentin e zbatimit të vendimit.

Kundër vendimit me numër A.nr.397/2020 të datës 21.12.2020, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 20.01.2021, duke kontestuar ligjshmërinë e tij.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi i`u referua dispozitave ligjore të Ligjit me NR. 06/L-114 për Zyrtaret Publik, respektivisht nenit 33 paragrafit 2 nen-paragrafi 2.1 i cili përcakton se, Pozitat në Shërbimin Civil grupohen sipas kategorisë, klasës dhe natyrës së pozitës. 2. Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendës drejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme.

Neni 49 i të njëjtit ligj përcakton se, krijimi dhe përbërja e komisionit disiplinor 1. Në çdo institucion, në fushën e veprimt të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së

paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse. 2. Kompetencat e komisionit disiplinor, për nëpunësit e kategorisë së lartë drejtuese në institucionin e administratës shtetërore, ushtrohen nga Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë. 3. Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë drejtohet nga ministri përgjegjës për administratën publike dhe përbëhet nga këta anëtarë: 3.1 dy (2) nëpunës të kategorisë së lartë drejtuese; 3.2 dy (2) personalitete të pavarura me përvojë profesionale dhe integritet të mirënjohur, përfaqësues të shoqërisë civile. 4. Anëtarët e Këshillit kanë mandat 5-vjeçar, me përjashtim të anëtarëve të parë, njëri prej të cilëve, i zgjedhur me short, zëvendësohet çdo vit. 5. Emërimi i anëtarëve të Këshillit, sipas paragrafit 2 të këtij neni, bëhet nga Qeveria, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike. Anëtarët që propozohen, përzgjidhen nga ministri përgjegjës për administratën publike në bazë të një procedure transparente, publike dhe konkurruese.

Ndërsa neni 56 përcakton se, Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji; 1.2. kur emërohet në një nga funksionet e parashikuara në paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 3 të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit; 1.3. transferohet, për nevoja të institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, qeveri të huaj apo në një institucion ndërkombëtar, për periudhën përkatëse; 1.4. kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi

Me tej, 57- Pezullimi Vullnetar përcakton se, pezullimi vullnetar bëhet me kërkesë të nëpunësit civil në rastet, si në vijim: 1.1. për kujdesin për të afërmit e moshuar ose të sëmurë (bashkëshorten/bashkëshortin, prindin, fëmijën, motrën/vëllanë) për një periudhë deri në 1 vjet; 2. Kërkesa për pezullim paraqitet me shkrim, së paku 15 ditë para datës së kërkuar të pezullimit, në Njësinë për Burimet Njerëzore të institucionit. Kërkesa miratohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ. 3. Pezullimi miratohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ. 4. Kategoria e nivelit të lartë drejtues nuk kanë të drejtë në pezullimin vullnetar.

Gjykata duke u bazuar nga shkresat e lëndës ka vlerësuar se, zhvillimi i procedurave respektivisht vendimi i datës 25.11.2020 i nxjerr nga Ministri i Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë me të cilin është pezulluar nga puna me 50% të pagës ankuesi ..., është nxjerr në kundërshtim në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit me NR. 06/L-114 për Zyrtares Publik, ku në mënyrë të qartë është përcaktuar se në cilat raste mund të bëhet pezullimi me 50 % të pagës nga vendi i punës, e që në rastin konkret ky i fundit nuk ka pasur kompetencë ligjore për të bërë pezullimin me 50 % të pagës së nëpunësit civil, këtu palës se interesit i cili ka pasur pozitën e sekretarit të përgjithshëm në këtë ..., sepse kjo çështje është përgjegjësi e Këshillit Shtetëror për Vlerësimin dhe Disiplinë ku neni 46 i Ligjit me NR. 06/L-114 për Zyrtares Publik përcakton se, shkeljet disiplinore dhe ndarja e tyre në shkelje të renda dhe të lehta të detyrave të punës, ndërsa nuk përcakton mënyrën e pezullimit të marrëdhënies se punës,

sepse pezullimi i marrëdhënies së punës përcaktohet në bazë të nenit 56 dhe 57 të ligjit të lartcekur, qoftë sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të nëpunësit civil kështu që asnjë nga dispozitat e nenit 56 dhe 57 të këtij ligji nuk ka përcaktuar që nëpunësit civil mund të pezullohet marrëdhënia e punës me 50% të pagës, kjo përcaktohet vetëm në rastin nëse ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, që deklarohet nga vetë nëpunësi, sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e tij në një pozite tjetër, në përputhje me neni 53 të këtij ligji.

Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar se pozita e Sekretarit të Përgjithshëm është pozitë e lart drejtuese, kështu që për çdo supozim të shkeljeve të detyrave të punës procedura mund të fillojë nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejt vetëm në Këshillin Shtetëror për Vlerësimin dhe Disiplinë ashtu siç parashihet me neni 49 paragrafi 2 Ligjit me NR. 06/L-114 për Zyrtaret Publik dhe neni 23 të Rregullores nr. 15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e nëpunësve të lart drejtues dhe jo të merr vendim për pezullim të marrëdhënies së punës me 50% të pagës, andaj zhvillimi i procedurës nga ana e punëdhënësit, respektivisht vendimi i datës 25.11.2020, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e ligjore në fuqi. Me tej, gjykata gjen se, me nxjerrjen e këtij vendimi, me të cilin ankuesit, në këtë rast palës së interesuar i është pezulluar marrëdhënien e punës me 50% të pagës, nuk i ka përmbushur obligimet ligjore dhe procedurale administrative të përcaktuara në Ligjin Për Procedurën e Përgjithshme dhe dispozitave të lartcekur të Ligjit me NR. 06/L-114 për Zyrtaret Publik dhe të Rregullores nr. 15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lart Drejtues.

Bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se i padituri drejtë ka vendosur kur ka aprovuar si e bazuar ankesën me numër A.nr.397/2020 e datës 08.12.2020 e parashtruar nga ankuesi dhe është shfuqizuar Vendimi me numër 01Ref.nr.45 i datës 25.11.2020 i Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ashtu që është obliguar, që të bëjë zbatimin e vendimit brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës në pozitën sekretar i përgjithshëm i dhe nga dita e pezullimit deri në momentin e zbatimit të vendimit.

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Paditësi me asnjë provë nuk dëshmon pretendimet e tij, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative-juridike.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj gjykata nuk i aprovoi

pretendimet e paditësit sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. 137/2021 data 18.04.2024

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.